



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR XHUVANI" ELBASAN
REKTORATI
REKTORI

Nr. 737 prot.

Elbasan, me 30.06.2014

Lënda: Kërkesë për përgatitjen e P/Buxhetit të vitit 2015 dhe parashikimet e viteve 2016 – 2017

Fakultetit/ Drejtorisë Financës

Në mbështetje të Ligjit nr. 9741 datë 21.05.2007 “Për Arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, Ligjin 9936 datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, kërkojmë dërgimin në Rektorat:

1. Projekte për kërkimin shkencor (Projektet të hartohen sipas modelit të emetuar nga AKTI).
2. Nevojat dhe projektet për investime në mjete e pajisje; pajisje laboratorike, pajisje për mësimdhënie (për departamentet), pajisje të veçanta për auditore etje.. Çdo projekt të ketë preventivin, specifikimet për çdo pajisje (përshkrimin për të dhënat teknike) dhe manualin e përdorimit të tyre.
3. Projekte të pajisjes së bibliotekës me fondin e nevojshëm të literaturës bashkëkohore (libra të ndryshëm) dhe jo më shumë se dy revista shkencore për fakultet.
4. Nevojat për ekspedita. Ekspeditat të paraqiten në kuadrin e planit mësimor të vitit 2014 – 2015 në të cilin të përshkruhet për çdo program mësimor: Numri i studentëve, itinerari i lëvizjes (brenda vendit), numri i ditëve të qëndrimit, qëllimi i programit mësimor që kërkohet të arrihet.
5. Nevojat materiale e shërbime korente për mësimdhënie (për departamentet), seminare, konferenca etje. (shpenzimet korente janë shpenzimet që kryhen brenda vitit (pagesa për materiale, pagesa për shërbime etje. dhe që nuk kanë karakterin e një investimi).
6. Planifikimin e orëve mësimore (të konvertuara) për vitin akademik 2014 – 2015, për çdo program mësimor dhe të ndarë sipas mbulimit nga punonjësit akademik: të brendshëm, të jashtëm.

Materialet të dërgohen brenda 15.07.2014

REKTORI
Liman Varoshi

